



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Kërkesa e KSHZ

Nr. 35

Data 2.11.2023
Nr. Prot 742

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
OBJEKTI: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ
DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve,

Nga organizata "Drejtësia Sociale" është depozituar, indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, nga 1 (një) institucion publik, për të cilin pretendohet se nuk është raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim. Indicia është marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, nenet 91, 92, neni 171, pika 1 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, përcaktojnë kompetenca për hetimin administrativ.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucioni publik nëpërmjet adresës së

postës elektronike, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkëljes të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendimin si më poshtë vijon:

- 1- Zj. Zerina Bruci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës, Z. Erion Vellaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për Bashkinë Tiranë dhe Zj. Abigeila Vushtina, Drejtor i Përgjithshëm në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor kanë organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 409 ID, për të cilin pretendohet si më poshtë vijon:

"Më datë 04.05.2023 ora 16:30 ministrja e Kulturës dhe kryetari i bashkisë Tiranë kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit të Operas dhe Baletit me artistë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental dhe në varësi të bashkisë Tiranë si drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia Studio Kadare, Galeria e Artit Tiranë etj. Ky takim është bërë në kuadër të fushatës për zgjedhjet lokale, në një ambient kulturor që është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe pa përdoret në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore si veprime të njëanshme nga ana e përfaqësuesve të institucioneve publike. Në takim citohen punët e bëra, premtimet për Muzeun Etnografik, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombëtar, Bienalja e Tiranës, mbështetja për Panairin e Librit etj."

Bashkëlidhur denoncimit në cilësinë e provave janë dërguar edhe provat link si më poshtë vijon:

<https://www.facebook.com/MarqaritiElva/videos/954092469346851/>

<https://www.facebook.com/MarqaritiElva/posts/pfbid02dVLëis3së2o4xn5s1GZ62hPbBCHdD3Q9jHGBtRb4AKë3yQehdBDMCUtRLroaBZuyI>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 11.05.2023, nëpërmjet postës elektronike, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Tiranë dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nga ku rezulton se asnjë prej institucioneve brenda afateve ligjore për kthimin e përgjigjes në lidhje me veprimtarinë publike, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim, për hetimin e rastit objekt shqyrtimi.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.05.2023, ora 12:00, ku u ftuan palët në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por asnjë prej palëve në proces nuk u paraqitën në këtë seancë.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 689, datë 10.07.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 407 ID dhe nr. 409 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", kam vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 409 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, asnjë prej palëve në proces nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare i është përgjigjur denoncuesi organizata "Drejtësia Sociale", e cila nëpërmjet emailit të datës 27.07.2023, ndër të tjera bën me dije se: "Ky takim është bërë në kuadër të fushatës për zgjedhjet lokale, në një ambient kulturor që është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe po përdoret në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore si veprime të njëanshme nga ana e përfaqësuesve të institucioneve publike. Në takim citohen punët e bëra, premtimet për Muzeun Etnografik, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombëtar, Bienalja e Tiranës, mbështetja për Panairin e Librit etj. Veprimtaria e kryer nga institucionet publike është bërë në shkelje të nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor për "Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve".

Më datë 06.10.2023, ora 12:00, të gjitha palët në proces janë ftuar në seancë publike, për të dhënë shpjegimet e tyre përfundimtare në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, për shkak se çështja me objekt shqyrtimi është komplekse dhe kërkon hetim të thelluar për të zbuluar organizatorin e kësaj veprimtarie publike.

Në seancë publike u paraqit në cilësinë e denoncuesit përfaqësuesi i organizatës "Drejtësia Sociale", zj. Gjyljana Bakallaj, e cila në deklaratimet e saj i qëndroi pretendimeve të depozituara nëpërmjet emailit të datës 27.07.2023, duke deklaruar se veprimtaria e zhvilluar nga njëri prej institucione si Ministria e Kulturës dhe Bashkia Tiranë, në ambientet e hollit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, është veprimtari publike, dhe institucioni organizator duhet të ndëshkohet për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në seancë publike u paraqit në cilësinë e përfaqësuesit të Institucionit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor zj. Migena Biba me detyrë Jurist dhe zj. Greta Gjinaj me detyrë Specialist në sektorin e Promocionit dhe Imazhit. Në prapësimet e tyre, përfaqësueset ndër të tjera deklaruan se:



"Në hollin e Institucionit tonë më datë 04.05.2023, janë organizuar dy koncerte të ndryshme nga ajo që pretendon denoncuesi të cilat kanë pasur për organizator koncerti i parë "Fondacionin Fridrich Ebert" Tirana, për të cilën disponojmë dhe kontratën e qirasë në lidhje me këtë koncert dhe koncerti i dytë "Troket Folk", nga Maestro Armaldo Kllogjeri. Asnjë prej këtyre koncerteve nuk është zhvilluar në hollin e Institucionit tonë, por në katin e dytë të Institucionit".

Në kuadër të hetimit administrativ për shqyrtimin e rastit iu kërkua përfaqësuesve të Institucionit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, të venë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Kontratën e Qirasë për koncertin e parë dhe pamjet filmike video në lidhje me koncertin e dytë.

Nëpërmjet emailit të datës 10.06.2023, përfaqësuesi i Tetarit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Kombëtar, bën me dije se: *"Bashkëlidhur me email po ju përcjellim:*

1.Kontratën e Qirasë nr. 316/1 Prot. date 27.03.2023, për koncertin e zhvilluar nga "Fondacioni Fridrich Ebert Tirana".

2.Pamjet filmike nga koncerti i zhvilluar në po të njëjtën datë "Troket Folk" nga Maestro Armaldo Kllogjeri (bashkëlidhur linku i aktivitetit instiucional).

<https://www.instagram.com/reel/Cr1PLILApki/?qshid=MzRIODBiNĒFIZA==>

Gjithashtu personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet emaili të datës 02.08.2023, ndër të tjera bën me dije se: *"Më datën 04.05.2023, Ministria e Kulturës nuk ka marrë pjesë në aktivitetin e sipërcituar, dhe si pasojë nuk mund të ketë raportim lidhur me këtë veprimtari".*

Më datë 20.10.2023, palët në proces u njoftuan për zhvillimin e seancës publike, për të parashtruar konkluzionet përfundimtare, në seancë u paraqit z. Gentian Sejrani, përfaqësuesi i organizatës "Drejtësia Sociale", i cili në dhënien e konkluzioneve përfundimtare parashtroi faktin se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020. Kemi të bëjmë me një veprimtari elektorale si nga Ministri i Kulturës ashtu edhe nga kryetari i bashkisë Tiranë, për shkak të thënieve të përdorura përgjatë eventit dhe mbajtjes së këtij takimi. Në këto kushte kërkojmë marrjen e masave për të sanksionuar personat përgjegjës për shkeljen e dispozitave ligjore.

Gjithashtu të pranishëm në seancë publike për dhënien e konkluzioneve përfundimtare përfaqësuesit e Institucionit të Tetarit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor zj. Migena Biba me detyrë Jurist dhe zj. Greta Gjinaj me detyrë Specialist në sektorin e Promocionit dhe Imazhit, të cilat pohuan faktin se: *"Veprimtaria është zhvilluar në ambientet e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, por në lidhje me datën e kryerjes së aktivitetit mohojmë faktin e kryerjes së këtij aktiviteti më datë 04.05.2023, për shkak se po në të njëjtën datë janë zhvilluar dy evente të tjera kjo e provuar nëpërmjet*



provave të dokumentuara dhe administruara tashmë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”.

Gjithashtu deklaruan se: “Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, është institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, dhe si i tillë nuk mund të ndalojë Ministrinë e Kulturës, në rastet kur mund të kërkojë vënien në dispozicion të ambienteve të Tetarit për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme politike apo institucionale. Ministria e Kulturës ka të drejtën e saj të kërkojë nga Institucioni jonë vënien në dispozicion të çdo ambienti të institucionit tonë”.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se natyra e aktivitetit të kryer për denoncimin regjistruar me nr. 409 ID, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportimin në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të dedikuar për këtë qëllim. Institucioni organizator duhet të mbajë përgjegjësi në lidhje me mosraportimin e veprimtarisë publike.

U provua se veprimtaria publike, është zhvilluar në ambientet e hollit të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, dhe është veprimtari publike, që për shkak të natyrës, fjalimit dhe pjesëmarrjes, provohet që është veprimtari publike e organizuar nga ana e Ministrisë së Kulturës.

Provohet që pjesëmarrja e z. Veliaj, është në kuadër të detyrave të tij funksionale, dhe nuk provohet të ketë thirrje elektorale apo mbështetje për t’a favorizuar si kandidat i regjistruar për zgjedhjet për kryetar bashkie për bashkinë, Tiranë.

Zhvillimi i veprimtarisë publike në ambientet e hollit të një institucioni publik, për përmbushjen e detyrave funksionale të Institucionit që ka organizuar këtë veprimtari publike, nuk ngarkon me përgjegjësi drejtorin e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, për sa kohë që është veprimtari institucionale e institucionit prej të cilit varet.

Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në Ministrinë e Kulturës, përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë nga 3 000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Zj. Zerina Bruçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës, gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:


- Vendimin nr. 812, datë 20.10.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të regjistruar me nr. 409 ID, nga Organizata " Drejtësia Sociale" nga personave përgjegjës në Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambli Popullor për mosraportimin e veprimatrive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 14 Maj, 2013;
- Denoncimi nr. 409 ID, nga organizata Drejtësia Sociale i administruar nga KQZ me nr. 4896, Prot., datë 10.05.2023;
- Porvat link:
<https://www.facebook.com/MargaritiElva/videos/954092469346851/>
<https://www.facebook.com/MargaritiElva/posts/pfbid02dVLëis3së2o4xn5s1GZ62hPbBCHdD3Q9jHGBtRb4AKë3yQehdBDMCUtRLroaBZuyI>
<https://www.instagram.com/reel/Cr1PLILApki/?igshid=MzRIODBiNËFIZA==>
- Komunikimi nëpërmjet postës elektronike mbi çështjen, objekt shqyrtimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Datë 09.05.2023

ANKESË

Drejtuar:

KOMISIONERIT SHTETËROR PËR ZGJEDHJET

Subjekti denoncues:

Organizata "Drejtësi Sociale", themeluar më 14.12.2020, me vendimin nr. 6599 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT M11509454W, me adresë Rruga Riza Cerova, nr.23, Tiranë, nr.kontakti 0698836881, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Gentian Sejrani

Subjekti i denoncuar:

Znj. Elva Margariti, Ministre pranë Ministrisë së Kulturës
Z. Erjon Veliaj, kryetar i bashkisë Tiranë

Objekti i kallëzimit:

Veprime të institucioneve publike

Adresa e vendit ku ka ndodhur shkelja:

Teatri i Operas dhe Baletit

Shkelja ligjore:

Më datë 04.05.2023 ora 16.30 ministrja e Kulturës dhe kryetari i bashkisë Tiranë kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit të Operas dhe Baletit me artistë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental dhe në varësi të bashkisë Tiranë si drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia Studio Kadare, Galeria e Artit Tiranë etj.

Ky takim është bërë në kuadër të fushatës për zgjedhjet lokale, në një ambient kulturor që është në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe po përdoret në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nënligjore si veprime të njëanshme nga ana e përfaqësuesve të institucioneve publike. Në takim citohen punët e bëra, premtimet për Muzeun Etnografik, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombëtar, Bialja e Tiranës, mbështetja për Panairin e Librit etj.

Veprimtaria e kryer nga institucionet publike është bërë në shkelje të nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor për "Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre".

Veprimtaria e kryer nga institucionet publike është bërë në shkelje të nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor për raportimin e aktiviteteve të ndryshme "Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë".

Kartona për info
- Ministrise se kulturës

- Bashkia Tiranë

- Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental (0698836881)

Sipas verifikimit të bërë në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ky aktivitet nuk rezulton të jetë njoftuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Vendimi nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” dhe vendimi nr.9 datë 09.09.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrative të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator përcaktojnë format e raportimit të aktiviteteve publike në kuadër të fushatës nga institucionet publike dhe procedurën që do të ndiqet për rastet e denoncuar.

Kjo veprimtari përbën veprimtari të ndaluar sipas nenit 3, pika 1.1 shkronja c) të Vendimit nr.9 datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” nga Komisioni Rregullator, konkretisht “mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekte publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore”

Veprimtaria e kryer nga subjektet e sipërcituara është e ndaluar dhe mbështetet dhe mbi vendimmarrjen e marrë nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet me vendimin nr.412 datë 25 prill 2023¹.


PËR SA MË SIPËR, KËRKOJMË MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SUBJEKTEVE TË CITUARA, MBËSHTETUR DHE MBI PËRCAKTIMET E NENIT 10 TË VENDIMIT NR.9 DATË 24.12.2020.

Provat dhe referencat:

<https://www.facebook.com/MargaritiElva/videos/954092469346851/>

<https://www.instagram.com/p/CryvzxHtDm4/?igshid=NTc4MTIwNjQ2YQ==>

¹ <https://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-412-date-25.04.2023-Per-shkronjen-bashkia-Korce.pdf>







Posts

About

Videos

Photos

More ▾



Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana is at Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Apr 25 · Tirana · 🌐

📍 Në datën 4 maj, Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT në bashkëpunim me **Fondacionin "Friedrich Ebert"**

do të organizojnë një ekspozitë fotografike që tregon historinë e pasur të sindikatës së telekomunikacionit. Ky është një mundësi për të mësuar më shumë për historinë e industrisë dhe individët punëtorë që luftuan për të drejtat e tyre dhe kushte më të mira pune.

Ekspozita do të zhvillohet në hollin e katit të dytë të "Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit (TKOB)" ku do të shfaqen fotografi që tregojnë historinë e rrugëtimit të sindikatave SPPT-AL nga fillimi i saj deri në ditët e sotme. Pra, nëse jeni një entuziast i telekomunikacionit ose thjesht dikush që kënaqet duke mësuar për të kaluarën, kjo ekspozitë nuk duhet humbur.

Të kujtojmë së bashku trashëgiminë e sindikatës së telekomunikacionit!

◆ Të interesuarit/rat duhet të konfirmojnë brenda datës 30 Prill 2023 në adresën:  enea.protopapa@fes.de

📍 On May 4th, "Albanian Post-Telecom Workers Union" in collaboration with "Friedrich Ebert" Foundation will organize a photo exhibition showcasing the history of the telecommunications trade union. This is an opportunity to learn more about the history of the industry and the hardworking individuals who fought for their rights and better working conditions.

The exhibition will be held in the lobby of the second floor



Home



Video



Friends



Marketplace



Notifications



Menu



Posts

About

Videos

Photos

More ▾

The exhibition will be held in the lobby of the second floor of the "National Theatre of Opera and Ballet" featuring photographs that tell the story of the SPPT-AL trade union's journey from its inception to its present day. So, whether you're a telecommunications enthusiast or just someone who enjoys learning about the past, this exhibition is not to be missed.

Let's remind the legacy of the telecommunications trade union together!

◆ Those interested must confirm by April 30, 2023, at the address: enea.protopapa@fes.de

32 YEARS OF TELECOMMUNICATION WORKERS UNION HISTORY

EXHIBITION PHOTO
the longer you look back, the farther forward you see...

04 May, 2023
7-9 PM
National Theatre of Opera and Ballet (TKOB)

RSVP by 30th April 2023 to enea.protopapa@fes.de



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Organized by SPPT - AL
and FES Tirana



Home



Video



Friends



Marketplace




Notifications




Menu





FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

32 VJET HISTORI E TË TELEKOM



32 VJET HISTORI E PËRPAJESËVE
TË TËLLEKOMARËK ADRIAT

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG







FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

32 VJET
HISTORIE E PUNONJËSVE
DHE PUNONJËSËVE
NË KOMBINATIN
KOMUNIKACIONIT

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



32 VJET HISTORIE E PUNONJËSVE
DHE PUNONJËSËVE
NË KOMBINATIN
KOMUNIKACIONIT



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



32 VJET

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG




















REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr 61 Prot
10

Tiranë, më 06/10/2023

A U T O R I Z I M

Autorizohet znj. Migena Biba me detyrë Specialist Jurist si dhe znj. Greta Gjinaj me detyrë Specialist në Sektorin e Promocionit dhe Imazhit pranë Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, bazuar në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë Titulli I “Përfaqësimi” Kreu I, neni 64 “Kuptimi dhe Llojet e Përfaqësimit”; Rregullores së Brendshme të Institucionit neni 42 “Përfaqësimi në gjykatë dhe tek të tretët i institucionit” për të përfaqësuar Institucionin e TKOBAP-së pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me denoncimin e regjistruar, me nr. 409 ID, me objekt: Mosrespektimin nga institucioni publik të detyrimit për raportim në ndërfaqen e raportimeve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtaritë publike si dhe zhvillimin e një veprimtarie të ndaluar.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA



Kerkese per informacion, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 5/11/2023 2:42 PM

To:Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>;Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>;Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>;Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>

Cc:socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>

Bcc:Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>;Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>;Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

📎 1 attachments (226 KB)

Denoncimi 409ID.pdf;

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim, i administruar me nr. 4896 prot. datë 10.05.2023, nga z. Gentian Serjani nepermjet te cilit nder te tjera pretendohet si vijon:

"Më datë 04.05.2023 ora 16:30 ministrja e Kulutes dhe kryetari i bashkise Tirane kane zhvilluar nje takim ne mjediset e hollit te Teatrit Kombetar, Teatrit Kombetar Eksperimental dhe ne varesi te bashkise Tirane si drejtues te Teatrit te Metropolit, Shtepia Studio Kadare, Galeria e Artit Tirane etj.

Ky takim eshte bere ne kuader te fushates per zgjedhjet lokale, ne nje ambient kulturor qe eshte ne varesi te Ministrise se Kultures dhe po perdoret ne kundershitm me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nenligjore si veprime te njeanshme nga ana e perfaqesuesve te institucioneve publike. Ne takim citohen punet e bera, premtimet per Muzeun Etnografik, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombetar, Bienalja e Tiranës, mbeshtetja per Panairin e Librit etj."

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për sa pretendohet nga denoncuesi, brenda 2 (dy) ditëve.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione qe parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Bashkelidhur ju percjellim denoncimin e administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



ORGANIZATA DREJTËSI SOCIALE

ADRESA: Rruga "Riza Cerova" nr. 23, Tiranë, Shqipëri;
E-MAIL: info@drejtesisociale.al; TEL: +355 (0) 69 883 6881

Tiranë më 04.10.2023

A U T O R I Z I M

Unë i nënshkruari Gentian Sejrani me detyrën si drejtor ekzekutiv i organizatës "Drejtësi Sociale", e themeluar me vendimin nr.6599 datë 14.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka në fokus:

- Të informojë dhe sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët e tjerë, veçanërisht grupet (egjiptian, rom, aftësi e kufizuar, grua, besimtarë, etj), për të drejtat dhe liritë themelore, si dhe mjetet ligjore të garantimit të tyre;
- Të advokojë dhe të mbrojë, në mënyrë proaktive, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, veçanërisht grupet (rome-egjiptiane, persona me aftësi të veçanta, studentët, të rinjtë, fëmijët, emigrantët, të burgosurit, punëmarrësit, besimtarë, banorët e lokaliteteve periferike, etj);
- Të ofrojë shërbim ligjor falas, në kuadër të litigimit strategjik, në ndihmë të viktimave që u janë shkelur të drejtat themelore dhe që janë në pamundësi financiare, dukë ofruar këshillim, trajtim ligjor, asistencë në përpilimin e akteve ligjore mbrojtëse dhe përfaqësim përpara organeve administrative qendrore dhe vendore, gjykatat e brendshme të gjitha niveleve si dhe gjykatave apo organizmave ndërkombëtarë relevante.

Autorizoj, Znj. Gjyljana Bakalli, i identifikuar me nr. ID J45204050P, me profesion juriste, të paraqitet në emër të organizatës "Drejtësi Sociale" për përfaqësim për ankesën e paraqitur pranë Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet me palë:

SUBJEKT DENONCUES: Organizata "Drejtësi Sociale"
SUBJEKT I DENONCUAR: Znj. Elva Margariti, ministre pranë Ministrisë së Kulturës
Z. Erion Veliaj, kryetar i bashkisë Tiranë
OBJEKTI I KALLËZIMIT: Veprime të institucioneve publike

Ky autorizim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

GENTIAN SEJRANI
Drejtor ekzekutiv



Re: Kerkese per informacion, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Wed 10/4/2023 2:25 PM

To:Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>;Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>;Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>;Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>
Cc:socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>
Bcc:Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>;Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>;Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përsëhendetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi hetimin administrativ të nisur ndaj Institucionit Tuaj.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e premte, më datë 6 Tetor 2023, ora 12:00, në adresë Rr. “Ibrahim Rugova”, nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime

Sent: Thursday, May 11, 2023 2:42 PM

To: Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>; Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>

Cc: socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>

Subject: Kerkese per informacion, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

Përsëhendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim, i administruar me nr. 4896 prot. datë 10.05.2023, nga z. Gentian Serjani nepermjet te cilit nder te tjera pretendohet si vijon:

"Më datë 04.05.2023 ora 16:30 ministria e Kulutes dhe kryetari i bashkise Tirane kane zhvilluar nje takim ne mjediset e hollit te Teatrit Kombetar, Teatrit Kombetar Eksperimental dhe ne varesi te bashkise Tirane si drejtues te Teatrit te Metropolit, Shtepia Studio Kadare, Galeria e Artit Tirane etj.

Re: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Tue 10/17/2023 11:37 AM

To: Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>; Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>; Migena Biba <Migena.Biba@tkob.gov.al>; sekretaria tkob <sekretaria@tkob.gov.al>
Cc: socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>
Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përsëndetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të vijojë me seancë publike të shtyrë nga seanca e datës 06.10.2023.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e premte, më datë 20 Tetor 2023, ora 12:00, në adresë Rr. “Ibrahim Rugova”, nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, July 27, 2023 1:47 PM

To: Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>; Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>

Cc: socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>

Subject: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

Përsëndetje,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar denoncimin e regjistruar me nr. **409 ID**, me objekt mosrespektimin nga institucioni publik të detyrimit për raportim në ndërfaqen e raportimeve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtaritë publike si dhe zhvillimin e një veprimtarie të ndaluar.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Bashkelidhur ju perçjellim denoncimin e administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Fw: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

Migena Biba <Migena.Biba@tkob.gov.al>

Fri 10/6/2023 2:55 PM

To:denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Cc:Rezearta Kokonozi <Rezearta.Kokonozi@kultura.gov.al>;sekretaria tkob <sekretaria@tkob.gov.al>

Pershendetje

Duke uruar te jeni mire , ne vijim te seances se mbajtur sot me date 06.10.2023 prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve , si dhe deklarimit te bere nga ana ime lidhur me pamundesine objektive per te qene prezent perfaqesues nga Ministria e Kultures, si dhe njoftimit mbi dergimin e e-mailit nga strukturat e ketij Institucioni, ju lutem gjeni me poshte kthim pergjigjen me e-mail te derguar nga Ministria e Kultures mbi ceshhtjen e diskutuar gjate kesaj seance.

Duke ju falenderuar

Fundjave te bukur ne vijim

Migena Biba

*Jurist pranë Drejtorisë të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse,
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor.
Adresa: Sheshi Skënderbej, Tiranë
web: <http://tkob.gov.al>*

From: Rezearta Kokonozi <Rezearta.Kokonozi@kultura.gov.al>

Sent: Friday, October 6, 2023 2:30 PM

To: Migena Biba <Migena.Biba@tkob.gov.al>

Subject: Fwd: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

Migena

Emaili qe folem. Faleminderit

[Get Outlook for Android](#)

hollit të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar dhe kanë akuzuar se me
 artistë të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe drejtues të Teatrit Kombëtar dhe kanë akuzuar se
 aktiviteti nuk është raportuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , ju bëjmë me dije si vijon:

Në datën 04.05.2023, Ministria e Kulturës nuk ka marrë pjesë në aktivitetin e sipërcituar,
 dhe si pasojë nuk mund të ketë raportim lidhur me këtë veprimtari.

Ju faleminderit.



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Në nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktoar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Në nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktoar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kuadër të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithanshëm ka administruar ka administruar të gjitha provat dhe pretendimet tuaja në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Duke qënë se ndodhemi në fazën e përfundimit të hetimit administrativ kërkojmë nga ana juaj paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, me shkrim, lidhur me procesin administrativ, përpara se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vijojë me vendimmarrje mbi këtë rast.

Përsa më sipër, afati për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare është brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmbja e këtij njoftimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime

Sent: Thursday, May 11, 2023 2:42 PM

To: Valbona Bataj <Valbona.Bataj@kultura.gov.al>; Alban Dokushi <alban.dokushi@tirana.al>; Blerina Korra <Blerina.Korra@tkob.gov.al>; Entela Cipa <Entela.Cipa@kultura.gov.al>

Cc: socialjusticeal@gmail.com <socialjusticeal@gmail.com>

Subject: Kerkese per informacion, Ministria e Kultures, Bashkia Tirane, Teatri Kombetar, Teatri Eksperimental (409)

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim, i administruar me nr. 4896 prot. datë 10.05.2023, nga z. Gentian Serjani nepermjet te cilit nder te tjera pretendohet si vijon:

"Më datë 04.05.2023 ora 16:30 ministria e Kultures dhe kryetari i bashkise Tirane kane zhvilluar nje takim ne mjediset e hollit te Teatrit Kombetar, Teatrit Kombetar Eksperimental dhe ne varesi te bashkise Tirane si drejtues te Teatrit te Metropolit, Shtepia Studio Kadare, Galeria e Artit Tirane etj.

Ky takim eshte bere ne kuader te fushates per zgjedhjet lokale, ne nje ambient kulturor qe eshte ne varesi te Ministrise se Kultures dhe po perdozet ne kundershitim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet nenligjore si veprime te njeanshme nga ana e perfaqesuesve te institucioneve publike. Ne takim citohen punet e bera, premtimet per Muzeun Etnografik, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombetar, Bienalja e Tiranes, mbeshetja per Panairin e Librit etj."

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për sa pretendohet nga denoncuesi, brenda 2 (dy) ditëve.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Bashkelidhur ju percejllim denoncimin e administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Posts

About

Videos

Photos

More ▾



Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana is at Teatri
Kombetar i Operas, Baletit dhe Ansamblit
Popullor.



Apr 25 · Tirana · 🌐

📍 Në datën 4 maj, Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT në bashkëpunim me **Fondacionin "Friedrich Ebert"**

do të organizojnë një ekspozitë fotografike që tregon historinë e pasur të sindikatës së telekomunikacionit. Ky është një mundësi për të mësuar më shumë për historinë e industrisë dhe individët punëtorë që luftuan për të drejtat e tyre dhe kushte më të mira pune.

Ekspozita do të zhvillohet në hollin e katit të dytë të "Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit (TKOB)" ku do të shfaqen fotografi që tregojnë historinë e rrugëtimit të sindikatave SPPT-AL nga fillimi i saj deri në ditët e sotme. Pra, nëse jeni një entuziast i telekomunikacionit ose thjesht dikush që kënaqet duke mësuar për të kaluarën, kjo ekspozitë nuk duhet humbur.

Të kujtojmë së bashku trashëgiminë e sindikatës së telekomunikacionit!

💎 Të interesuarit/rat duhet të konfirmojnë brenda datës 30 Prill 2023 në adresën: 📧 enea.protopapa@fes.de

📍 On May 4th, "Albanian Post-Telecom Workers Union" in collaboration with "Friedrich Ebert" Foundation will organize a photo exhibition showcasing the history of the telecommunications trade union. This is an opportunity to learn more about the history of the industry and the hardworking individuals who fought for their rights and better working conditions.

The exhibition will be held in the lobby of the second floor



Home



Video



Friends



Marketplace



Notifications



Menu



Posts

About

Videos


Photos

More ▾

The exhibition will be held in the lobby of the second floor of the "National Theatre of Opera and Ballet" featuring photographs that tell the story of the SPPT-AL trade union's journey from its inception to its present day. So, whether you're a telecommunications enthusiast or just someone who enjoys learning about the past, this exhibition is not to be missed.

Let's remind the legacy of the telecommunications trade union together!

◆ Those interested must confirm by April 30, 2023, at the address: ➡ enea.protopapa@fes.de



RSVP by 30th April 2023 to enea.protopapa@fes.de



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Organized by SPPT - AL and FES Tirana



Home



Video



Friends



Marketplace



Notifications




Menu





FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

32 VJET HISTORI E TË TELEKOM



FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



32 VJET HISTORI E PUNONJESVË
TË TELEKOMUNIKACIONIT.

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG







**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



32 VJ

**RI E PUNONJËSVE
KOMUNIKACIONIT**



32 VJET HISTORI E PUNONJËSVE
TE TELEKOMUNIKACIONIT

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**















REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20 Tetor 2023

Nr: 812

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT REGJISTRUAR ME NR. 409 ID, NGA ORGANIZATA "DREJTËSIA SOCIALE" NDAJ PERSONAVA PËRGJEGJËS NË MINISTRINË E KULTURËS, BASHKINË TIRANË, NË TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS DHE BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR PËR MOSRAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 20 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Organizata "Drejtësia Sociale"

SUBJEKT: Zj. Zerina Bruci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës
Z. Erion Veliaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për Bashkinë Tiranë
Zj. Abigeila Vushtina, Drejtor i Përgjithshëm në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 20 Tetor 2023

Nr: 812
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 409 ID, për shkelje administrative"

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, struktura përgjegjëse për kryerjen e hetimit administrative pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion sqarues në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe, institucionin organizator të kësaj veprimtarie dhe arsyen e mosraportimit dhe mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Më datë 11.05.2023, nëpërmjet postës elektronike, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Ministrisë së Kulturës, Bashkisë Tiranë dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Ansambllit Popullor, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nga ku rezulton se asnjë prej institucioneve brenda afateve ligjore për kthimin e përgjigjes në lidhje me veprimtarinë publike, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim, për hetimin e rastit objekt shqyrtimi.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.05.2023, ora 12:00, ku u ftuan palët në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por asnjë prej palëve në proces nuk u paraqitën në këtë seancë.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 689, datë 10.07.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 407 ID dhe nr. 407 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", kam vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 409 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, asnjë prej palëve në proces nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare i është përgjigjur denoncuesi Organizata "Drejtësia Sociale", e cila nëpërmjet emailit të datës 27.07.20223, ndër të tjera

Data: 20 Tetor 2023 Nr: 812
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID për shkelje administrative"

dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Kontratën e Qerasë për koncertin e parë dhe pamjet filmike vdeo në lidhje me koncertin e dytë.

Nëpërmjet emailit të datës 10.06.2023, përfaqësuesi i Tetarit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Kombëtar, bën me dije se "Bashkëlidhur me email po ju përcjellim:

1. Kontratën e Qirasë nr. 316/1 Prot. date 27.03.2023, për koncertin e zhvilluar nga "Fondacioni Fridrich Ebert Tirana".
2. Pamjet filmike nga koncerti i zhvilluar në po të njejtën datë "Troket Folk" nga Maestro Armaldo Klogjeri (bashkëlidhur linku i aktivitetit instiucional). <https://www.instagram.com/reel/Cr1PLILApki/?igshid=MzRIODBiNĒFIZA==>

Gjithashtu personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike praë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet emaili të datës 02.08.2023, ndër të tjera bën me dije se "Më datën 04.05.2023, Ministria e Kulturës nuk ka marrë pjesë në aktivitetin e sipërcituar, dhe si pasojë nuk mund të ketë raportim lidhur me këtë veprimtari".

Më datë 20.10.2023, palët në proces u njoftuan për zhvillimin e seancës publike, për të parashtruar konkluzionet përfundimtare, në seancë u paraqit z. Gentian Sejrani, përfaqësuesi i Organizatës "Drejtësia Sociale", i cili në dhënien e konkluzioneve përfundimtare parashtroi faktin se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020. Kemi të bëjmë më një veprimtari elektorale si nga Ministri I Kulturës ashtu edhe nga Kryetari i bashkisë Tiranë, për shkak të thënieve të përdorura përgjatë eventit dhe mbajtjes së këtij takimi. Në këto kushte kërkojmë marrjen e masave për të sanksionuar personat përgjegjës për shkeljen e dispozitave ligjore.

Gjithashtu të pranishëm në seancë publike për dhënien e konkluzioneve përfundimtare përfaqësuesit e Institucionit të Tetarit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor zj. Migena Biba me detyrë Jurist dhe zj. Greta Gjinaj me detyrë Specialist në sektorin e Promocionit dhe Imazhit, të cilat pohuan faktin se "Veprimtaria është zhvilluar në ambjentet e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, por në lidhje me datën e kryerjes së aktivitetit mohojmë faktin e kryerjes së këtij aktiviteti më datë 04.05.2023, për shkak se po në të njejtën datë janë zhvilluar dy evente të tjera kjo e provuar nëpërmjet provave të dokumentuara dhe administruara tashmë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Gjithashtu deklaruan se "Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, është institucion varësie i Ministrisë së Kulturës, dhe si i tillë nuk mund të ndalojë Ministrinë e Kulturës, në rastet kur mund të kërkojë vënien në dispozicion të ambjenteve të Tetarit për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme politike apo institucionale. Ministria e Kulturës ka të



Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në Ministrinë e Kulturës, përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për rrjedhojë, referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimeve dhe Sanskioneve marrjen e masës administrative për:
 - Zj. Zerina Bruçi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Kulturës.
2. Pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj zj. Abigeila Voshtina, Drejtor i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.
3. Pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 20 Tetor 2023 Nr: 812
Ora: 12:00

*Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID për shkelje administrative

**Procesverbal dorëzimi i materialit te zbardhur në seancën publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Nr.	Dokumenti		Sasia e fletëve	Shkurtimi i lëndës	Shënime
	Numër	Datë			
1	2	3	4	5	6
			1	Fleta e inventarit	
	Vendimi nr. 812	20.10.2023	20	Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023	
Totali			21		

Mbyllet me numrin rendor 2 (dy)

Spektori i Protokollit dhe Arkivës

Anduela NDREU



Tiranë, më 26.10.2023

Specialiste, stenografe

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

6.10.2023
Ora 12:44

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)


OJF “Drejtësia Sociale”, (znj. Gjyljana Bakalli)

TKOBAP (znj. Greta Gjinaj, znj. Migena Biba)

Z. I. Celibashi: Pika 10, shqyrtimi administrativ që lidhet me denoncimin 409 ID, i Organizatës “Drejtësia Sociale”.

Znj. M. Koja: Organizata “Drejtësia Sociale”, denoncues në rastin konkret, denoncon një veprimtari të zhvilluar në datën 4 maj, në orën 16:30. Takim ky i zhvilluar në mjediset e hollit të Teatrit Kombëtar, me pjesëmarrës nga Ministria e Kulturës, kryetari i Bashkisë Tiranë, Teatri Eksperimental, drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia-studio “Kadare”, Galeria e Arteve Tiranë, etj. Sipas denoncuesit ky është një aktivitet në kuadër të fushatës për zgjedhjet vendore, në një ambient

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

kulturor në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe po përdoret në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej se kush është organizatori i veprimtarisë, nëse është Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, apo muzeu në rastin konkret. Në këto kushte, kjo është një veprimtari e cila është më natyrë institucionale, pjesëmarrja e përfaqësuesve nga ministria, apo dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë është në funksion të detyrave të tyre funksionale. Është veprimtari që ka pas detyrim të raportohet dhe nuk rezulton të jetë raportuar. Mbetet e paqartë se kush është institucioni mbi të cilin bie përgjegjësia për të raportuar.

Z. I. Celibashi: Ka ndonjë përfaqësues nga organizata?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Përhëndetje, Gjyljana Bakalli. Nga zbardhja që është bërë nga takimi që është dhe video e hedhur në facebook nga ana e ministres së kulturës, janë bërë premtime elektorale. Janë përmendur edhe punë që janë bërë, kështu që nuk mendoj se është takim institucional duke qenë se ka qenë dhe në orar pune dhe janë prezent edhe drejtuesit e institucioneve. Sërish në median sociale të ministres janë të pasqyruara eventet dhe ka thënë që “do të kthejmë bienalen, do të ndërtohet Muzeu i Artit Modern, do të vazhdojë ndërtimi i Teatrit Kombëtar..”. Pra, janë premtime elektorale. Mendoj se është veprimtari e ndaluar dhe është kryer duke shfrytëzuar një institucion publik që është holli i Teatrit të Operas dhe Baletit, jo i Teatrit Kombëtar siç u citua, por TOBAP. Është dhe me foto, vijojnë të jenë publike në rrjetet sociale të ministres, sepse nga bashkia nuk e kemi gjetur, është dhe me video. Kështu që i qëndrojmë pretendimit që është veprimtari e ndaluar dhe personat përgjegjës, pavarësisht kush është organizator... dhe për ne është e qartë që e organizon Bashkia Tiranë, sepse është event që u zhvillua për shkak të fushatës dhe zhvillohet në Tiranë. Duke qenë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

se dhe ministria zotohet bashkë me Erjon Velian, kryetarin aktual të bashkisë. I qëndrojmë pretendimit që është veprimtari e ndaluar dhe duhet të ketë sanksion administrativ për të dy personat për të cilët ne kemi ngritur pretendime, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Jam Migena Biba, juriste e institucionit dhe Greta Gjinaj, specialiste e promocionit në TKOBAP. Të dyja jemi të përfaqësuara me autorizim. Ne jemi njohur me e-mail në datën 11 maj që ka ardhur në institucion, po zoti Kryetar, mendojmë se nuk legjitimohemi në këtë proces, në këtë denoncim, sepse ne jemi Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Ndërsa në e-mail është referuar Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimental. Gjithsesi në bazë të ligjit tonë organik për artin dhe kulturën, institucioni TKOBAP është një institucion publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Gjithsesi, referuar e-mail që keni dërguar në datën 4 maj, ora 16:30, ministria e kulturës dhe kryetari i Bashkisë Tiranë, citoni ndër të tjera që “kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Tëtrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental, në varësi të Bashkisë Tiranë, si drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia-studio “Kadare”, Galeria e Artit Tiranë”. Asnjë nga këto institucione që ju keni cituar nuk ka të bëjë me institucionin tonë, e para. Ajo që është më e rëndësishme në datën 4 maj, janë zhvilluar dy aktivitete të cilat ne i kemi dhe të provuara dhe me dokumentacion. Një prej tyre është... kemi bërë një kontratë qeraje në bazë të kërkesës që ka sjellë subjekti pranë institucionit tonë dhe tjetri është koncerti i maestros Armando Kllogjeri. Këto ne mund t’i depozitojmë pranë Komisionerit. Gjithashtu nga Ministria e Kulturës, sot më është dërguar dhe një informacion që e kishim të pamundur për të ardhur dhe paraqitur në seancë, por kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

dorëzuar një e-mail, ku sqarojnë dhe pozitën e tyre. I nderuar Kryetar, duke qenë se ne nuk legjitimohemi në proces, jemi një institucion i ndryshëm nga sa denoncon shoqëria, si dhe në atë datë nuk janë zhvilluar aktivitete për të cilat ata pretendojnë, por janë zhvilluar dy aktivitete të cilat janë në kuadër të veprimtarisë sonë institucionale, mendojmë që kërkesa nuk duhet të merret parasysht. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kishit diçka tjetër?

Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Po, edhe diçka! Kontrata e qerasë ka qenë me një gjerman, kam koorespondencën nëpërmjet e-mail, që ka nisur që në datën 21 mars 2023, pasi unë bëj dhe asistenten e drejtorit të përgjithshëm dhe jam personi përgjegjës e cila kam raportuar çdo aktivitet përgjatë periudhës para zgjedhore. Nisur nga e-mail, kam nga Eneo Protopapa, i cili ishte personi përgjegjës i Fred Rikebertinfung, ka ardhur e-mail që në datën 4 maj të kërkonin hollin e katit të dytë koncertor, nga ora 18:45 deri në orën 20:45. Për efekt kohe, në atë periudhë salla, pra në 4 maj, ishte e lirë dhe ata kërkuan që të paktën minimumi dy orë para aktivitetit, sepse ishte ekspozitë, donin të bënin montim të ledwoll-it, që do të thotë që ata janë futur në orën 17:00 dhe e kanë marrë hollin tre orë me qera. Gjithashtu vlen të theksohet se në orën 19:30, ata kanë dalë jashtë, për arsye se do të niste koncerti “Troket folk”, nga maestro Kllogjeri, të cilat vërtetohen shumë lehtë nga mediat tona sociale, ku kemi banerin. Pra, janë dy aktivitete që kemi pas atë ditë pasdite, të cilat nuk rakordojnë me atë që na kanë denoncuar për hollin dhe skenën e TKOBAP.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

Z. I. Celibashi: Jeni duke thënë që “aktiviteti i denoncuar nga ana e Organizatës “Drejtësia Sociale”, nuk është zhvilluar në ambientet tuaja”, me sa kuptoj unë?! Këtë jeni duke thënë!

Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Po sipas datës që ata na referohen. Data 4.05...

Z. I. Celibashi: Se në këtë datë, thoni ju, kur pretendohet se është zhvilluar aktiviteti i denoncuar, ju keni pasur aktivitete të tjera në TKOPB?

Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Po, të cilat vërtetohen nga kontrata e qerasë me nr. 316/1, dt.27.03., pra që është lidhur kjo kontratë qeraje.

Z. I. Celibashi: Jeni duke thënë që “janë vetëm këto dy aktivitete të zhvilluara në atë datë dhe s’ka asnjë aktivitet tjetër”?!


Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Po, s’ka asnjë aktivitet tjetër.

Z. I. Celibashi: Nuk ka qenë ministria e kulturës, dhe...

Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: As Bashkia Tiranë, apo Teatri Kombëtar, Eksperimental, të cilët denoncohen nga ana e shoqatës në datën 4 maj.

Z. I. Celibashi: Jo, ju nuk përfaqësoni Teatrin Eksperimental? Po thoni që në ambientet që ju zotëroni si institucion, nuk janë zhvilluar këto dy aktivitete.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Jo! Kemi pas një kontratë qeraje dhe ne kemi një kalendar artistik me të cilin ecim me një bord artistik që është miratuar me datën 22.12.2022 për këto aktivitete.

Z. I. Celibashi: E kuptova! Kemi ndonjë gjë për të shtuar?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Më vjen keq që zonjat janë dhe në varësi të ministres, se jeni duke kundërshtuar ministren që... është data 4 maj, është nxjerrë nga facebooku, është live video nga ambientet e TKOBAP. Ne nuk kemi thirrur si palë TKOBAP, sot e mora vesh. Ne kemi kërkuar dhe denoncuar si subjekt ministren dhe kryetarin e bashkisë, ndaj nuk kemi... Ne e kuptojmë që thjesht është bërë një aktivitet, është bërë te hollit në kat të parë. Fatmirësisht, unë jam frekuentuese e atij ambienti dhe e di mirë se si është i organizuar, konkretisht është organizuar në hollin e katit të parë, jo të katit të dytë.


Z. I. Celibashi: Ndoshta mos janë dhe data të ndryshme, mbase ka nevojë të shihen datat. Pretendimi juaj është që ky aktivitet është zhvilluar në një prej holleve të TKOBAP, apo jo?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po!

Z. I. Celibashi: Jo në Teatrin Eksperimental?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Jo, jo! E kemi cituar vendin, por është dhe video live e ministres.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord! Përfaqësuesit... ose njëra prej palëve gënjen, ose është e pasaktë, pasaktësia mund të lidhet me datën?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Nuk e di si mund të futesh live në facebook një ditë më vonë, po ne kemi pretendimin që ky takim është zhvilluar në ambientet e hollit të TKOBAP. Na vjen shumë keq që as përfaqësuesit e ministrisë dhe as përfaqësuesit e bashkisë nuk kanë bashkëpunuar me ju. As ne nuk kemi një informacion se çfarë ka ndodhur. Ne i qëndrojmë...

Z. I. Celibashi: Ata kana sjellë shpjegimet e tyre dhe ministria ka sjellë një shpjegim. Çështja është se sa qëndrojnë ato si pretendime, po tej kësaj, ajo çfarë ju pretendoni është fakti që, veprimtaria nuk është raportuar?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po!


Z. I. Celibashi: Dhe ka qenë veprimtari me karakter politik dhe elektoral?

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po!

Z. I. Celibashi: Nëse është veprimtari me karakter politik dhe elektoral, natyra e shkeljes është tjetër, që do të thotë që në një veprimtari me karakter politiko-elektoral, janë përdorur asetet publike...

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

Z. I. Celibashi: Nëse veprimtaria ka qenë institucionale dhe jo elektorale, pretendimi juaj shkon që të lidhet me mungesën e raportimit të asaj veprimtarie. Pra, do të duhet të jetë ose njëra, ose tjetra. Nëse është veprimtari politike-elektorale nuk ka pas detyrimin askush për ta raportuar, po nëse ka qenë veprimtari institucionale, atëherë është detyrimi për të raportuar. Nëse kjo veprimtari institucionale është katandisur në veprimtari politike dhe elektorale, atëherë ka dhe një shkelje tjetër që lidhet me përdorimin e aseteve publike për qëllime politike dhe elektorale. Ju, i qëndroni pretendimit se në atë datë nuk ka... Po në lidhje me provën që paraqet pala denoncuese sipas të cilës rezulton se janë pamje të marra nga facebook-u i ministres, në datën që ata pretendojnë se është zhvilluar ky aktivitet?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: I nderuar Kryetar! Ne i qëndrojmë pretendimeve tona. Në datën 4 maj, në ambientet e institucionit të TKOBAP janë zhvilluar dy aktivitete. Njëra, sipas kontratës së qerasë është ekspozitë dhe tjetra ka qenë “Troket Folk”, i maestros Armando Kllogjeri. Këto kanë qenë.

Z. I. Celibashi: Kontrata e qerasë nuk presupozon që mund të jetë zhvilluar aktiviteti. Keni ndonjë dokument që e keni zhvilluar aktivitetin në atë datë?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Po, patjetër!

Z. I. Celibashi: Ndonjë foto, ose ndonjë procesverbal, ndonjë ditar?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Foto, unë nuk kam për momentin, sepse ky është një aktivitet që zhvillohet nga të tretët, por ama kemi një kontratë e cila ka në objekt të saj “çeljen e një ekspozite me foto të sindikatës së punonjësve të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

telekomunikacionit”. Kemi orare të përcaktuara, me çdo gjë. Është një aktivitet që kryhet nga të tretët dhe ne nuk i dokumentojmë. E rëndësishme për institucionin është që aktiviteti dhe objekti të jetë i ligjshëm, të mos jetë për arsye politike që kemi detyrime të tjera. Nuk kam diçka për momentin, por mund të dokumentohet.

Z. I. Celibashi: Mundet, keni diçka që mund ta paraqesni?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Kam vetëm kontratën e qerasë.

Z. I. Celibashi: Jo, veç asaj.

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Veç kësaj, për këtë kontratë nuk kam një dokument për momentin. Ndoshta mund të hapim arkivën që të vërtetojmë që kemi një çelje ekspozite?


Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP: Mund të hapen kamerat. Ne nuk e vërtetojmë dot përveç përfaqësuesit me të cilin kemi kontratën e qerasë.

Z. I. Celibashi: Edhe kjo mund të ishte e mjaftueshme “që kemi qenë”!

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Tjetra është Maestro “Troket Folk”. Është aktivitet i kalendarit artistik, miratuar nga Bordi Artistik, është pjesë e institucionit tonë, nuk është aktivitet për të cilin ju pretendoni.

Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”: Kjo është zhvilluar brenda te salla e TKOBAP, ne po flasim për hollin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.6.10.2023*

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Zonjë e nderuar, përpara se t'i drejtoheni institucionit tonë, duhet të jeni më të saktë dhe mos shkaktoni rrëmujë. Ju nuk i drejtoheni TKOBAP, po ne përsëri i jemi përgjigjur Komisionerit duke i shpjeguar dhe duke treguar dhe gatishmërinë tonë për të ardhur në këtë seancë, së pari. Pastaj për datën që ju i referoheni, janë vetëm këto dy aktivitete, mos na vendosni në pozita sikur ne po themi diçka të gabuar.

Z. I. Celibashi: Këtë e sqaruam, që bëhet fjalë për institucionin tuaj, po ju pretendoni se në atë datë nuk është zhvilluar në institucionin tuaj aktiviteti që pretendon pala denoncuëse, e kam të qartë. Keni kontratën e qerasë, por thatë që mund të sillni një dokument shtesë për të provuar këtë. Atëherë, meqenëse kemi të gjithë komoditetin e kohës për ta trajtuar këtë çështje, po ju japim mundësinë që të paraqesni çfarë ju keni shtesë, në mbështetje të asaj çfarë ju thatë sot në lidhje me këtë çështje. Dakord?! Mirë faleminderit! Do t'ju njoftojmë për një ditë tjetër, po ndërkohë ju mund të deponitoni në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duke filluar nga tani e më pas.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

**20.10.2023
Ora 12:07**

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. E. Meta, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dhimitër Zguri)

OJF “Drejtësia Sociale”, z. Gentjan Sejrani (avokat)

TKOBAP (znj. Greta Gjinaj, znj. Migena Biba)

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite: Projektvendimin që lidhet me “Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.

Projektvendim “Për plotësimin për plotësimin e vakancave në këshillin bashkiak të Bashkisë Malësi e Madhe, Bashkia Kamëz, Bashkia Devoll, Bashkia Vau i Dejës, Bashkia Lezhë, Bashkia Sarandë.

- Kemi, shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues Ervin Muharremi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Klos;

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

- për subjektin vetëdeklarues Valter Hasanaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vlorë;

- për subjektin vetëdeklarues Fatlind Sokolaj, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tropojë.

Kemi dhe çështje të mbartura nga seancat e kaluara:

- shqyrtime administrative të denoncimit të Organizatës “Drejtësia Sociale”, të “Qëndresës Qytetare”.

Në fund kemi dy projektvendime:

- “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021” dhe projektvendimi tjetër për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

Atëherë, meqenëse kemi një kërkesë për të bërë një zhvendosje në rradhën e shqyrtimit të çështjeve, nga përfaqësuesi i Organizatës “Drejtësia Sociale”, nëse nuk kemi ndonjë pretendim nga pjesëmarrësit e tjerë në seancë, do të përfundojmë me të gjitha çështjet të cilat janë të mbartura dhe pastaj të kalojmë te çështjet rishtazi për shqyrtim.

Atëherë, nga çështjet e mbartura, pika e parë ka të me shqyrtimin administrativ që të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale”, ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Nëse nuk gaboj e kemi shtyrë seancën për të verifikuar në lidhje, si me vendin e zhvillimit të aktivitetit, ashtu dhe për natyrën e aktivitetit. Kështu është?

Znj. M. Koja: Po! Atëherë, sot vijojmë shqyrtimin administrativ për denoncimin me numër ID 409 bërë nga Organizata “Drejtësia Sociale”, ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental”. Kështu është objekti i denoncimit. Gjatë shqyrtimit administrativ, ne kemi konstatuar që në datën 4 maj 2023, në ambientet e TKOBAP është zhvilluar një aktivitet me pjesëmarrjen e Ministres së Kulturës, kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe disa artistëve. Informacioni është marrë nga faqja e rrjetit social Facebook të ministres, ku të dhënat janë për një transmetim live të veprimtarisë, në datën 4 maj 2023. Në seancën e kaluar kemi dëgjuar pretendimet e palëve pjesëmarrëse, si nga Teatri Kombëtar, ashtu dhe nga Ministria e Kulturës. Nga këqyrja e videos në faqen Facebook, konstatohet se ai është një takim me artistë zhvilluar nga Ministria e Kulturës, me pjesëmarrjen e ministres së Kulturës konkretisht, me artisë sipas fushës së përgjegjësisë së kësaj ministrie dhe me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë. Gjatë fjalës së ministres dhe kryetarit të bashkisë nuk ka thirrje për të votuar për një forcë politike, apo për ndonjë kandidat. Është një takim dhe fjalë që ka të bëjë me projekte të ndryshme të kryera, në zbatim e sipër, apo në të ardhmen në lidhje me fushën e kulturës së teatrit. Nga sa pretendohet nga Drejtoria e Përgjithshme e TKOBAP sikundër u pohua nga ana e tyre në seancën e kaluar, në këtë datë, në ambientet e TKOBAP janë zhvilluar dy aktivitete të tjera që nuk kanë të bëjnë me këtë veprimtari. Nga sa këqyret në video, kjo veprimtari është zhvilluar në mjediset e TKOBAP dhe sa informacion kemi ne është zhvilluar në datën 4 maj, sikundër e përcakton vetë rrjeti social. Kështu që në këto kushte, ne mendojmë që është një veprimtari me karakter publik, pavarësisht se nuk e përcaktojmë dot nëse organizator ka qenë Ministria e Kulturës, apo vetë TKOBAP, ka pas detyrimin për ta raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. në këto kushte propozojmë që t’i propozohet KAS-it, sanksion administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin në Ministrinë e Kulturës dhe në TKOBAP.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Z. I. Celibashi: Dakord! Përfaqësuesit, si të organizatës dhe të TKOBAP!

Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po i Nderuar! Për sa i përket..., unë thjesht do të theksoj disa nga pasazhet e fjalimeve që kanë pasur Ministria e Kulturës dhe kandidati për kryetar bashkie në qytetin e Tiranës, zoti Erjon Velia. Do të doja të theksoja fjalën e saj zonja Margariti e ka filluar “E dimë që fushata na sjell atë ritëm për t’u takuar me sa më shumë njerëz, por nuk ka asgjë të keqe fakti që jemi në fushatë. Që jemi për të dëgjuar dhe kritikuar që sot na munguan..”. Pra, pasazhi i parë që e lidh drejtë për drejtë me një aktivitet politik dhe elektoral. Pasazhi i dytë po i zonjës Margariti, “Me Erjonin kemi bërë shumë e më shumë. Çfarë kanë bërë më shumë bashkitë e tjera, sepse kam gjetur një bashkëpunëtor të mirë...”, që sërish e lidh me një aktivitet politik dhe elektoral. Gjithashtu në fjalën e tij zoti Erjon Veliaj ka shprehur se, “Më shumë se sa forcat politike këtu ndeshen ide. Kur ne bëmë amfiteatrin ishte një investim i cili ka qenë në memorje e daljeve tona nga liqeni me prindër dhe nuk ka rëndësi nëse në ato kohë ka qenë Ansambli i Ushtrisë, apo të tjerë”. Pra, ka disa pasazhe që tregojnë qartazi se ka pas një aktivitet me karakter politik, elektoral dhe nuk kemi të bëjmë me një aktivitet publik për sa i përket zhvillimit të aktivitetit, Ndërsa për sa i përket konstatimit që dhe nga ana juaj pas hetimit administrativ ka ndodhur “është e zhvilluar”, nisur nga diskutimi që ka pas herën e kaluar, kur u ngrit pretendimi që “nuk ka ndodhur si aktivitet” është e provuar. Është ende e publikuar në faqen zyrtare të ministres si aktivitet që ka qenë në një periudhë kur është fushatë zgjedhore. Gjithashtu dhe pasazhet e fjalive e lidhin drejtpërdrejtë me një aktivitet politik elektoral dhe nuk është një aktivitet kulturor ku mund të flitej për artin dhe të tjera gjëra.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e TKOBAP?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: I Nderuar, pasi u njohëm edhe njëherë me konkluzionet, le të themi përfundimtare, ne i qëndrojmë pretendimeve që kemi mbajtur dhe në seancën e datës 6 tetor. Nuk e di se çfarë ka ndodhur, mund të jetë ndoshta ndonjë regjistrim.. dmth që takimi është zhvilluar në ndonjë datë tjetër dhe është hedhur në Facebook në datën 4. Ajo që ne na rezulton dhe në bazë edhe të provave që kemi për aktivitetin, në TKOBAP janë janë zhvilluar dy aktivitete. Një kontratë qeraje që e kemi thënë dhe koncerti pjesë e kalendarit maestros “Troket Folk”. Nuk e di se çfarë ka ndodhur...


Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Është fakt i njohur tashmë dhe është i konfirmuar dhe nga ana e KQZ-së. Për sa i përket pretendimeve tuaja, ato janë pretendime që ju keni të drejtë që i keni ngritur, por ky është fakt i provuar tashmë dhe është ende në faqen publike të ministres si aktivitet i publikuar në atë datë. Nëse teknologjia mundëson që të jetë zhvilluar në një datë tjetër dhe e publikon në një datë tjetër, kjo është tjetër gjë. Por që kjo është e publikuar në datën 4 maj të vitit 2023 është fakt i provuar dhe që është konfirmuar edhe nga ana e institucionit përkatës.

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Atë po thoja...

Z. I. Celibashi: Vetëm ju lutem me rradhë në kërkesën për të folur!

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Këtë po thoja, aktiviteti mund të jetë publikuar në datën 4, por nuk ka provë që të vërtetojmë që është zhvilluar në një datë të hershme,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

psh në datën 3 dhe e kanë publikuar më pas. Në datën 4 në institucion janë vetëm këto aktivitete. Këtë, unë nuk marr përsipër, pra nuk kam asnjë provë për ta vërtetuar, por që nuk më bën sens. Ne kemi këto dy aktivitete, kemi marrë dhe provat nga “Fondacioni Fridrich Elbert Tirana”, i cili na ka vënë në dispozicion fotot, pamjet që është zhvilluar aktiviteti. Detyrë kjo e lënë nga Komisioneri për të vërtetuar me foto dhe dokumentacion që ne pohuam që është zhvilluar ky aktivitet. Fotot janë dhe në faqen sociale Facebook të fondacionit, kështu që mund t’i verifikoni dhe ndërkohë është aktiviteti tjetër që është pjesë e detyrës tonë funksionale si institucion. Ndaj mendoj që mund të ketë diçka përtej kësaj, mund të jetë zhvilluar më herët, por jo në datën për të cilën ne po flasim.

Z. I. Celibashi: Një pyetje kam, ai aktivitet gjykuar nga pamjet është zhvilluar në ambientet e TKOBAP? Pa diskutuar në lidhje me kohën, pra datën?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Vetëm t’i shoh edhe njëherë që të identifikoj?


Z. I. Celibashi: Janë ende dhe sot në faqen e Facebook-ut.

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Qartë, unë këtu mund të identifikoj që këto janë ambientet e TKOBAP.

Z. I. Celibashi: Dakord! Dmth ky aktivitet biem dakord që është zhvilluar në ambientet e TKOBAP. Ju pretendoni që në datën kur pretendon pala denoncuese, aty ka pasur një aktivitet tjetër, kështu që nuk është zhvilluar në atë datë.

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Po, korrekt!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Z. I. Celibashi: Një pyetje kam, ky aktivitet që është zhvilluar të themi në datën 3, 4, 5 pra, nuk po marrim në konsideratë kohën kur është zhvilluar, në dijeninë tuaj, aktivitet i kujt ka qenë? I juaji, i Ministrisë së Kulturës, i Bashkisë Tiranës, apo i dikujt tjetër? Nëse keni dijëni!

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Nuk kam dijëni se i kujt ka qenë aktiviteti, nuk mund të shprehem se kush ka qenë organizatori.

Z. I. Celibashi: E kuptoj, ndoshta është edhe... në kushtet e një hetimi...

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Jo, ju kuptoj Kryetar, ajo që është e rëndësishme është që aktiviteti...

Z. I. Celibashi: Duket sikur po bëj një hetim penal, por në fakt kështu janë kërkesat e ligjit, edhe pse e bëjmë kaq serioze, shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe kujt do tjetër që...

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Jam shumë dakord, por ajo që është e rëndësishme është se nuk ka qenë aktivitet i yni, dmth nuk ka qenë në kalendar dhe një aktivitet i brendshëm, kjo është pak më e sigurtë. Ndërsa se i kujt ka qenë, nuk mund ta them, nuk kam informacion.

Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Që nuk është aktivitet publik...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Z. I. Celibashi: Ju lutem jo pa leje, ju jeni dhe avokat, merrni pjesë në gjykime në gjykatë... Ju thoni që nuk ka qenë aktivitet i ynë, me bindje për këtë gjë?! Dakord, në rregull! Po, fjala për ju!

Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Për sa i përket deklarimit të fundit që nuk ka qenë aktivitet i tyre, dmth që nuk kemi të bëjmë me një aktivitet kulturor të organizuar nga Teatri i Operas dhe Baletit. Kemi të bëjmë .., pra, kjo na çon automatikisht në një aktivitet politik elektorale.

Z. I. Celibashi: Me rregull treshi nuk i bie kështu (*thënë me humor*)? Kemi diçka tjetër për të thënë në lidhje me këtë çështje? Ndonjë provë që kërkoni të administrohet tani?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Provat që ne kërkojmë të administrohen në këtë seancë janë fotot e marra nga faqja e “Fondacioni Fridrich Elbert Tirana”, të cilat duam t’i dorëzojmë, për të vërtetuar dhe njëherë qëndrimet që ne kemi mbajtur në seancë.

Z. I. Celibashi: Dakord, do t’i administrojmë dhe ato! Nga ana e denoncuesit?

Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po, i Nderuar! Kemi zbardhjen e të dy fjalimeve në takim të ministres dhe kryetarit të bashkisë.

Z. I. Celibashi: Dakord, ne i kemi shkarkuar nga faqja e Facebook-ut ato pamje dhe do t’i administrojmë si prova. Mirë dakord! E përfundojmë hetimin administrativ.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

Përfundimisht ju kërkoni., po ju jap dhe njëherë fjalën për të na thënë se çfarë kërkoni përfundimisht.

Z. G. Sejrani, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Sociale”: Po i Nderuar! I qëndrojmë denoncimit të bërë para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse është e qartë se aktiviteti është zhvilluar në një institucion publik siç është TKOBAP, pavarësisht pretendimeve që mund të kenë përfaqësuesit e institucionit, që në këtë rast nuk qëndron. Ligji është mjaft i qartë, ndalon vënien në përdorim të institucioneve publike për aktivitete politike dhe elektorale gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Është e qartë që është një aktivitet elektorale, sepse provohet nga fjalimi i zonjës Margariti dhe zotit Veliqaj. Kërkoj sanksionimin e kandidatit për kryetar bashkie për shkeljen e kryer dhe të zonjës Margariti si person zyrtar që ka marrë pjesë në kryerjen e shkeljes, si dhe të drejtorit të TKOBAP duke lejuar shfrytëzimin e burimeve dhe asetëve publike.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i TKOBAP?

Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP: Ne si institucion i qëndrojmë pretendimeve që kemi bërë në seancë dhe dokumentacionit të dorëzuar në seancën e sotme. Sa deklarohe nga denoncuesi nuk është e vërtetë. Në datën 4 maj janë mbajtur dy aktivitete nga ana e institucionit tonë, të cilat janë të dokumentuara dhe dorëzuar në këtë seancë.

Znj. G. Gjinaj, specialiste promovimi në TKOBAP: I nderuar Kryetar! Duhet të theksoj se ne jemi institucion varësie i Ministrisë së Kulturës dhe për çdo aktivitet që Ministria e Kulturës mund të kërkojë hollet ose ambientet e teatrit, ata e kanë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.20.10.2023*

drejtën e tyre të vijnë dhe të zhvillojnë konferenca, aktivitete, që do të thotë se ne jemi institucion varësie, kështu që...

Z. I. Celibashi: Po, e kuptova shumë mirë! Kemi gjë tjetër? Dakord, qartë! Në vlerësimin tonë si KQZ, në lidhje me këtë denoncim, aktiviteti që është zhvilluar atje, nuk mund të përkufizohet si aktivitet elektoral. Edhe nga përmbajtja e diskutimeve, mendoj se do të ishte e tepruar në rast se çfarë është thënë nga pjesëmarrësit, përkufizohet si aktivitet elektoral. Sjellja në referim, periudha kur po zhvillohet aktiviteti, nuk e bën aktivitetin elektoral. Në gjykimin dhe vlerësimin tonë është një aktivitet publik i cili do të duhej të ishte raportuar dhe në lidhje me raportimin, përgjegjësia për ta raportuar, i takon Ministrisë së Kulturës, duke konsideruar dhe argumentin e fundit të përfaqësuesve të TKOBAP. Propozoj vendosjen e sanksionit për personin përgjegjës në Ministrinë e Kulturës për mosraportim të këtij aktiviteti.

Vendimi nr. 812

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

